

KËRKESË
Nr. 12542, datë 9.10.2018
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, për pasurinë e paluajtshme pronë private, me nr. 3/1257, ZK 8621, e cila preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit Krujë”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është Bashkia Krujë.

Me anë të këtij publikimi kërkohet që të vihen në dijeni personat të cilët preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit Krujë”, për shpronësimin e pasurive të tyre, si dhe për masën e vlerësimit, të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera e shpronësimit, për pasurinë nr. 3/1257, ZK 8621, për të cilën kërkohet publikimi është 9,285,465.00 (nëntë milionë e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
PROJEKTI “ZGJERIMI I RRUGËS HYRËSE TË QYTETIT, PARKIMI DHE RIKUALIFIKIMI I QENDRËS
SË QYTETIT KRUJË” (SHITESË)

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Rrethi	Sip. e truallit (m²)	Sip. e ndërtimit (m²)	Çmimi i truallit (l/m²)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera totale	Shënime
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
13	Kujtim Guni, Afërdita Guni, Arben Guni, Meleq Guni dhe Paquze Guni (Gjoni)	8621	3/1257	Krujë	2,315.00	—	4,011	9,285,465.00	—	9,285,465.00	Konfirmuar nga ZVRPP- ja Krujë. Pasuri e llojit truall.